

Prof. Dr. Hamit BORIÇI\*

## NAIM E SAMI FRASHËRI DHE REVISTA "CKRONJ MËSIMI E PËRHERCIME"

Revista "Drita"- "Dituria" ("Ckronj mësimi e përhercime") njihet si një prej organeve të para të shtypit të periudhës së Rilindjes Kombëtare, sepse është e para revistë e përkohshme didaktiko-pedagogjike shqiptare. E ideuar dhe orientuar nga vëllezërit Naim e Sami Frashëri, ajo nisi të botohej më 10 gusht 1884 në Stamboll (Turqi). Gjatë viteve 1884-1885, dolën 12 numra me nga 16 faqe.

Fletorja "Drita"- "Dituria" qarkulloi pas të përjavshmes "I foni this Alvania" (Zëri i Shqipërisë) të Anastas Kulluriotit (1879-1880) dhe krahas "Fjamuri Arbërit" të De Radës (1883-1887).

Pandeli Sotiri, duke e marrë në sy rrezikun që i kanosej nga qeveritarët osmanë apo reaksioni shovinist grek (që në Stamboll ishte i fuqishëm), mbajti përgjegjësinë e pronarit të së përmuajshmes". Ai ka hyrë edhe në historinë e gazetarisë së periudhës së Rilindjes Kombëtare, "jo vetëm si drejtues i revistës, por edhe me shkrimet e tij".<sup>1)</sup> Që nga numri 2, vazhdimisht e deri në fund, revista doli me emrin e ri "Dituria" dhe "nën kujdesin e Pandeli Sotirit"<sup>2)</sup>. Atdhetari në zë nuk vuri asnjë kusht, siç bëri paraardhësi i tij, Petro Poga, i cili pas daljes në dritë të numrit të parë (10 gusht 1884), u tërhoq.

Gjasa është se Petro Poga, njëri prej anëtarëve të Shoqërisë Shqiptare të Stambollit, nuk i përballoi trysnitë e qarqeve shoviniste greke. Prandaj në një parashtrësë në gjuhën greke, Poga vuri si kusht botimi, kontrollin paraprak të përmbajtjes nga Ministria e Arsimit të Turqisë.

---

\* Publicist, pedagog dhe historian i gazetarisë shqiptare

Porta e Lartë e lejoj të përmuajshme e shtrënguar nga shkallëzimi e ashpërsimi i kundërshtive mes qeverisë së Stambollit dhe asaj të Athinës dhe nga frika e kryengritjes së armatosur të shqiptarëve ndaj Stambollit, që nxitej nga qarqe të caktuara greke; nga çoroditja që kishte krijuar shtrirja dhe rikoordinimi i lëvizjes kombëtare shqiptare, mes Stambollit, Bukureshtit dhe qendrave shqiptare në atdhe, në veri të së cilës (Lumë e Gjakovë, Pejë e Ferizaj, Tetovë, etj.) vazhdonin luftimet.

Naim e Sami Frashëri qenë ideorë të "*Shkronjë mësimi e përhershme*", njëherësh edhe autorë të një vargu shkrimesh. Ata, së bashku me Jani Vreton, Pandeli Sotirin e Koto Hoxhin, synuan dhe ia arritën ta zgjerojnë spektrin problemor të revistës.

\*\*\*

Në të vërtetë, kjo revistë deri më sot mbetet e para në historinë e shtypit shqiptar, jo vetëm si botim i natyrës pedagogjike, por edhe si një organ kulturor shkencor, letrar e më tej, me synime të dukshme, me përmbajtje e prirje të theksuara kombëtare.

Përmbajta, tematika dhe problematika e saj përshkohet nga ideja iluministe e Rilindjes, se "pa emancipim kulturor nuk mund të ketë emancipim politik".<sup>3)</sup> Me lëndë të përzgjedhur, në përpjekje për t'iu përgjigjur gjendjes së zhvillimit, kërkesave dhe nevojave të kombit në rrethana të caktuara, e përmuajshmja del përpara opinionit shoqëror bashkëkohës me një orientim të qartë e të drejtë kombëtar, ku ndërthuret pedagogjia me politikën. Hapur e tërthorazi, në numrin e parë grishen atdhetarët, që duke parë përvojën e shumë kombeve në botë, shqiptarët "kësaj drite" (...) me i dhanë flakë për me shndritë kombin.

Meritë e autorëve dhe e Pandeli Sotirit, si drejtor përgjegjës i kësaj reviste, është ngjizja e mendimit kulturor me atë politik kombëtar, rrjedhshëm e natyrshëm, pa sforcim, realizohet me interpretime logjike prej mësuesi, shkrimtari e publicisti njëherësh.

Një vështrim i thelluar i koleksionit të revistës nxjerr në pah drejtimit kryesorë ideo-pedagogjike, ideopolitike kombëtare, përvijuar nga njëri numër në tjetrin.

Së pari, misioni zyrtar, miratuar nga qeveria në lejen e botimit të "Dritës" është "*ndritja e mendjes me çdo farë diturie*". Duket prirja e redaksisë për të ushqyer lëvizjen kombëtare me dashurinë për

gjuhën shqipe, për të mësuarit dhe edukatën në gjuhën amtare. Kjo ishte një nga çështjet kryesore të Shoqërisë së të Shtypurit Shkronja Shqip, në Stamboll.

Me një përkujdesje të admirueshme gjuhësore janë hartuar shkrimet, duke ndikuar kështu te lexuesit, në të mësuarit e të edukuarit për një shqipe të shkruar, një toskërishte e punuar për atë kohë, me synime perspektive, për një gjuhë letrare shqipe të njësuar. Ndihet në to thirrja për bashkim e njësim kombëtar, që nga rrafshi gjuhësor dhe shtrihet në atë politik dhe anasjelltas.

Në mjaft shkrime rrihet mendimi se "çdo popull që nuk ka të shkruar gjuhën e vet dhe në këtë gjuhë nuk ka libra, ndodhet në errësirë". (H.B. tërthorazi kërkesë politike, që u përcjell në shumë peticione).

Këtej vjen natyrshëm përfundimi i redaksisë: "shqiptarët e shohin shumë të nevojshme të shkruajnë gjuhën dhe të kenë më shumë libra në gjuhën e tyre".

Së dyti, drejtimi letrar "merr vlera të veçanta, parë në dritën e kohës. Numri i parë hapej me vjershën e mirënjohur të Naim Frashërit "*Fjalët e qiririt*". Vjershat e copëzat në prozë të poetit, botuar në revistë (bashkëdrejtues e bashkëpunëtorë kryesor i së cilës ishte) janë përfshirë në vëllimet "Vjersha për mësonjëtorët e para", "E këndimit të çunavet këndonjëtoreja", etj. Vargjet e Koto Hoxhit, si dhe fragmente nga romani i shkrimtari francez, Fransua Fenelo "Të ngjarat e Telemakut", përkthyer nga Pandeli Sotiri, përforcojnë prirjen letrare të kësaj të përkohshmeje. Prandaj studiuesit kanë shfaqur mendimin se revistën mund ta quajmë nismëtare të një faqeje të re të madhe në letërsinë e, përgjithësisht në kulturën e re shqiptare".<sup>4)</sup>

Së treti, me një varg artikujsh shkencorë, shkruar në gjuhë të kuptueshme për fëmijë, por edhe për të rritur, motivohet orientimi kulturor-shkencor. Në rubrikat e shtyllat e revistës janë botuar disa shkrime me karakter studimor, me arsyetime e meditime filozofike të Sami e Naim Frashërit, Jani Vretos e Pandeli Sotirit.

Së katërti, edukimi qytetar është një nga tiparet e dukshme të këtij organi e shtypi dritëdhënës. Sami Frashëri botoi disa shkrime didaktike me orientim të qartë - formimin qytetar të lexuesve, ku mëson se "Qytetaria është rrojtje e njeriut mbi dhetë me dituri, me urtësi, me butësi, me pasje e me çfarëdo lehtësije". (H.B. ide e teza

për shumë artikuj e pamflete në publicistikën politike shqiptare të Rilindjes e më tej). Me këto synime, ai trajtoi, në rrafsh politik, historik e shoqëror ciklin "Qytetari e grekëve", "Qytetari e Arabisë" dhe "Qytetari e Europeanëve". Naim Frashëri me "Fjalë për të vegjëlitë" ushqen dashurinë për "mëmën e atënë, motrën e vëllanë, miqtë e fqinjët, farë e fisnë dhe gjithë njerëzinë". (H.B. - Ideja e "Bashkimit", sa gazeta me këtë emër; e Paqes, e mirëkuptimit...).

Koto Hoxhi përmes vargjeve të botuara fton breznitë në mësonjëtoje për mirësi; Jani Vreto hedh idenë- linjë thelbësore e misionit të gazetarisë: të shkruarit e të vërtetës, që ai e shpreh kështu: "Për të vërtetën edhe shkronjëne e së vërtetës".<sup>5)</sup>

Së pesti, atdhetarizmi-orientimi kryesor, tipari themelor i përmbajtjes së këtij periodiku, çka shpesh edhe hapur, gjallon thuajse në çdo shkrim publicistik, shkencor, veçanërisht në krijimtarinë letrare. Shquhet Naim Frashëri për kurajë qytetare tek del jashtë kornizave të përcaktuara nga qeveria e Stambollit në lejen e votimit. Në poezinë alegorike "Shkëndij" e diellit manushaqes", poeti qan për Shqipërinë, rrezaton disi të ardhmen e saj. (H.B. Shpreh realitetin, por inkurajon, zgjon shpresën dhe orienton për ardhmëninë!). Në vargjet e Koto Hoxhit ndërthuret dëshira për dituri e mjeshtëri, me atë të dashurisë e të bashkimit kombëtar. Mësuesi i nderuar grish vasha e djem dhe i këshillon të mos mungojnë: /"Ndë mjeshtëri, ndë dituri/, /ini të lidhur me dashuri/ (H.B.-Bashkim)/Mëmdheun tuaj ta nderoni/".

Në dritë të diellit pohohet në një shkrim diturak se "*shqiptarët sot gjithë janë një komp...kanë një gjuhë, një gjak, një zemër e një fis*". Shkruhej kështu kur lëvizja kombëtare në trevat shqiptare, e jashtë saj, merrte karakter të organizuar; kur shpërndarja e Lidhjes së Prizrenit kishte çuar në një zbatice të lëvizjes atdhetare; kur situata ndërkombëtare karakterizohej nga një stabilitet i përkohshëm, i rremë.

\*\*\*

Për idetë e problemet që shtronte, revista përndiqej nga censura, se, siç i shkruante Sami Frashëri De Radës, më 20 shkurt 1881, "turku nuk do zgjuarjen e shqiptarëve", as "përhapjen e idesë kombëtare të popullit shqiptar".<sup>6)</sup>

Dhe një ditë, kur Jelldis Qoshku e humbi durimin, (pasi revista,

në dukje e qetë, ua ndizte ndjenjat e lexuesve, kaliste dëshirën e vullnetin për çlirim nga zgjedha osmane) ndaj mori vendimin e prerë: "Jasak!". Revista u ndalua në numrin e saj të 12-të.

### **Bibliografia:**

1. Hysni Myzyri - Gazeta "Mësuesi", Tiranë, 13 janar 1986, f. 3.
2. Pirro Tako - Gazeta "Drita", T. 1984, 19 gusht, f. 12.
3. Hysni Myzyri -Shkollat e para kombëtare shqipe-, Tiranë, 1978, f. 15.
4. Dhimitër S. Shuteriqi- "Gjurmime letrare" -, Tiranë 1974, f.269.
5. Ahmet Kondo- Revista "Studime historike", Tiranë, 1970, nr. 3, f. 141-155.
6. AQSh. Fondi Sami Frashëri, Dosja 4. Fl.1